REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TE TIRANES 6089

Nr. 6081 i Aktit

VENDIM

"PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK"

Ne Tirane,sot me date _______1993 une gjyqtari mbasi u njoha me materialet e paraqitura nga Bujar Tuku dhe Lura Kasa,te dy nga Tirana,per tu regjistruar si persona juridik,

KONSTATOVA

Kerkuesit Bujar Tuku dhe Laura Kasa kane paraqitur kerkesen per te regjistruar si persona juridik Shoqerine tregtare private te themeluar nga ana e tyre ne ortakeri dhe qe mban emertimin"DEAN CUSTOM AGENCY",me seli ne Tirane,me kapital fillestar prej 10000 /dhjetemije/ USD? dhe me n: nje afat veprimtarie te pa kufizuar e mbi 10 vjet.Objekti i aktivitetit ekonomik te kesaj Shoqerie perfshin veprimtarine ne fushen e Agjensise se ndermjetesive doganore,transaksione te ndryshme import-eksport,zyre per kembimin e valutave,veprimtari tregtare te artikujve te ndryshem industral dhe ushqimor me shumuce e me pakice si ne import e ne eksport,transport te mallrave industriale dhe ushqimore brenda dhe jashte vendit per llogari te Shoqerise dhe te te treteve,operacione tregtare komisionerie si dhe çdo aktivitet tjeter qe veçs ose se bashku me ato te permendura me lart do te konsiderohet i pershtatshem e me leverdi per rritjen e zhvillimin e Shoqerise.

Kerkesa e tyre eshte e bazuar dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE

Ne baze te nenit 5 te ligjit 512 date 10-08-1991 dhe ligjit per shoqerite tregtare,

VENDOSA

Regjistrimin si person juridik te Shoqerise tregtare "DEAN CUSTOM AGENCY" te ortakeve themelues Bujar Tuku dhe Laura Kasa per te ushtruar aktivitetin privat ne:"Veprimtari ne fushen e Agjensise doganore,me transaksione te ndryshme import-eksport,zyre per kembim valute,veprimtari tregtare te artikujve te ndryshem industrial dhe ushqimor me shumice e me pakice si ne import e ne eksport, transport te mallrave industrial dhe ushqimor branda dhe jashte vendit per llogari te Shoqerise dhe te te treteve,operacione tregtare komisionerie,si dhe çdo aktivitet tjeter qe vqças ose se bashku me ato te permendura me lart do te konsiderohet i pershtatshem e me leverdi per zhvillimin e shoqerise.

Kunder vendimit lejohet e drejta e ankimit.

GJYQTARI

Malesh

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA " DEAN CUSTOM AGENCY" SH.P.K.

PULLE TAKSE 100 LEKE

VENDIM

I ORTAKEVE TE SHOQERISE

Nr. 1, date 09.03.1999

Sot ne daten 09.03.1999 ne ortaket e shoqerise "Dean Custom Agency" sh.p.k,Bujar Tuku dhe Laura Kasa , shoqeri e regjistruar ne Gjykate me vendimin nr.6089, date 13.8.1993, ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 " Per shoqerite Tregtare" si dhe duke patur parasysh nenet e statutit te themelimit te saj, mori ne shqyrtim kerkesen e ortakut Laura Kasa, per ndryshime ne statut te shoqerise dhe konkretisht trasferim nepermjet te shitjes se kuotave te ortakut Bujar Tuku.

Ne perfundim te mbledhjes ne ortaket ,

VENDOSEM

l- Te largohet nga shoqeria ortaku Bujar Tuku.

2. Shitjen e kuotave 50 % ose 5000 usd te ortakut Bujar Tuku.

Ortak I vetem I shoqerise mbetet Laura Kasa dhe Administrator i saj mbetet ortaku Laura Kasa

3. T'i behet kerkese gjykates se Rrethit Tirane per te bere ndryshimet ne regjistrin tregtar te saj nga Ortaku Bujar Tuku

ORTAKET

BUJAR TUKU LAURA KASA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR 1813 REP
NR 418 KOL

VERTETIM

Sot ne daten 11 03.1999 perpara meje Noteres Mimoza Sadushi, me zyre ne Rr. e " Durresit " , Pall. 11, u paraqiten personalisht Z.Bujar Tuku dhe Laura Kasa, me zotesi te plote per te vepruar, te cilet nenshkruan para meje aktin e mesiperm dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE

MIMOZA SADUSHI

13

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 6089/1 I Vendimit
6293

# VENDIM

## I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 12.03.1999, une gjyqtarja e Gjykates se rrethit Tirane, Ornela Cofo, pasi shqyrtova kerkesen dhe dokumentet e tjera te paraqitura nga kerkuesi Laura Kasa, per Shoqerine " DEAN CUSTOM AGENCY ", shpk,

## Konstatova,

LAURA KASA me cilesine e Administratorit dhe Ortakut te Shoqerise "DEAN CUSTOM AGENCY ", shpk, person juridik I regjistruar me Vendimin e Gjykates se rrethit Tirane Nr. 6089, date 13.8.1993, me seli ne Tirane me kapital 1000 USD, ka paraqitur kerkese per depozitim ne regjistrin tregtar, te ndryshimeve ne perberjen e ortakeve te shoqerise, duke u bere ortak I vetem I shoqerise dhe Administrator I saj, LAURA KASA, E cila merr persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet e Shoqerise. Bashkelidhur kerkeses ajo ka paraqitur Vendimin e largimit nga shoqeria te ortakut Bujar Tuku dhe kontraten e shitjes se kuotave te ortakut Bujar Tuku ortakut te vetem Laura Kasa.

Nga shqyrtimi rezultohnj se kerkesa eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te nenit 24 dhe dispozitave te tjera te ligjit Nr. 7667, 7638 e 7632,

## VENDOSA:

Pranimin e kerkeses per depozitimin ne Regjistrin Tregtar, te Vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise " DEAN CUSTOM AGENCY " shpk.

Urdherohet zyra e regjistrit Tregetar te beje shenimet perkatese ne Kollonen 4 e 5 dhe ndarjen me vize te kuqe .

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim.

GJYQTARE
Ornela Cofo

15

******************************************************************************

A K T - TH E M E L U E S

K O N T R A T E DH E S T A T U T I I
SH O Q R I S E P R I V A T E
"D E A N C U S T O M A G E N C Y"

10-8-1993 T I R A N E

******************************************************************************

3

S T A T U T I

I SHOQERISE PRIVATE "DEAN CUSTOM AGENCY"

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr 7638,date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe Ligjit Nr 7594,date 4.08.1992 "Per Investimet e Huaja",

Z.Bujar Tuku dhe Znj.Laura Kasa duke patur zotesine ligjore per te vepruar,u muaren vesh per sa vijon:

F O R M I M I

N E N I 1

Formohet Shoqeria Private me emrin "DEAN CUSTOM AGENCY" me pergjegjesi te kufizuar e ortakeve themelues:
Z.Bujar Tuku,lindur ne dhe banues ne Rruga "Pjeter Bogdani"vila 39 Tirane dhe numer pasaporte AZ451413.
Znj.Laura Kasa,shtetase Shqiptare,lindur ne Tirane me 25-04-1964 dhe banuese ne Tirane,Rruga "Mine Peza" Pll.2/1,Ap 6

VEND QENDRIMI

N E N I 2

Vend qendrimi legal i soqerise "DEAN CUSTOM AGENCY" eshte aktualisht ne Tirane,Ruga "Mine Peza" Pa.2/1,shk.1,ap.6 Tirane.

Shoqeria mund te hape edhe vend qendrime te tjera,filiale agjensi,si dhe perfaqsi ne te gjithe teritorin e Shqiperise si dhe jashte saje,me miratimin e organeve perkatese dhe sipas legjislacionit te vendit ku ato hapen.

KOHE ZGJATJA

N E N I 3

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise "DEAN CUSTOM AGENCY" eshte mbi 10 vjet.Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

N E N I 4

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise "DEAN CUSTOM AGENCY" eshte per sa vijon:
-Veprimtari te agjensise se ndermjetsimeve doganore me sherbimet perkatese,magazinime doganore,sigurimin e furnizimeve per mjetet e transporteve te ndryshme e te udhetareve e njesite e shitjes se lire.
-Transaksione te ndryshme ne import-eksport.
-Zyre per kembimin e valutave.
-Veprimtari tregetare te artikujve te ndryshem industriale e ushqimore me shumice e me pakice si ne import dhe eksport.
-Transport te mallrave industriale e ushqimore,brenda dhe jashte vendit per llogari te shoqerise dhe te te treteve.

-Operacione tregetare komisionerie.
Si dhe cdo aktivitet tjeter,qe vecas ose se bashku me ato te permendura me larte,do te konsiderohet i pershtatshem e me leverdi per rritjen e zhvillimin e shoqerise "DEAN CUSTOM AGENCY".

N E N I 5

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin,vendqendrimin dhe objektin e veprimtarise se saje sipas vendimeve qe do te marrin ortaket themelues pronare te shoqerise.

KAPITALI I SHOQERISE

N E N I 6

Kapitali fillestar i shoqerise eshte prej 10.000 USD,formuar ne mase te barabarte,Z.Bujar Tuku 5000 USD dhe Znj.Laura Kasa 5000 USD,i ndare ne kuota nga 50% per sejcilin ortak.

N E N I 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose mund te pakesohet sipas vendimeve qe do te marrin ortaket e shoqerise,por ne asnje rast njeri ortak nuk mundet te detyroje ortakun tjeter te rrise kuoten e tije ne kapitalin e shoqerise.

N E N I 8

Kuotat e pjesmarjes ne kapital jane te gjitha te emertuara e te pandarshme;ato nenshkruhen,shlyhen plotesisht dhe ndahen ortakeve sipas perpjestimit te formimit te kapitalit prej tyre.Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

N E N I 9

Ortaku qe ka ndermend tu shese te treteve kuotat e tije pjeserisht ose teresisht duhet te njoftoje me pare ortakun tjeter te shoqeris i cili ka te drejten e blerjes se pare.Kjo e drejte duhet ushtruar brenda 30 diteve nga data e komunikimit.Ne rast te moskomunikimit,te moszbatimit e te moushtrimit te te drejtes se blerjes se pare,ortaku qe do te shese kuotat e tije,duhet ti komunikoje ortakut tjeter emrin e bleresit te ri si dhe kushtet e shitjes.Keto kushte nuk mund te jene me te favorshme se ato te ofruara ortakut te shoqerise i cili do te jete i preferuar ne kushte te barabarta.

ORGANET DREJTUESE

N E N I 10

Organet drejtuese te shoqerise jane:Asambleja e ortakeve dhe administratori(keshilli administrativ).

Fusha e veprimit,perberja dhe menyra e punes te organeve drejtuese,emertimi dhe shkarkimi i anetareve dhe ceshtje te rendesishme per funksionimin e tyre regullohen sipas ketije statuti dhe kontrates se shoqerise.

NENI 11

Asambleja e Shoqerise perbehet nga dy ortaket themelues. Asambleja e Shoqerise eshte organ sovran i saj.Themeluesit e saje qeverisin ate duke u mbeshtetur ne te drejten e tyre te prones private dhe mjeteve te investuara ne kete shoqeri.Vendimet qe merre Asambleja sipas ketije Statuti dhe ligjeve ne fuqi,jane te detyrueshme per te dy ortaket e Shoqerise.Vendimet e Asamblese formulohen dhe nenshkruhen nga Presidenti i Shoqerise.

Asambleja thirret sa here shikohet e aresyeshme nga dy themeluesit e Shoqerise por detyrimisht ne Dhjetor per te miratuar organizimin e veprimtarise se Shoqerise per vitin e ardhshem si dhe ne muajin Mars per te miratuar bilancin kontabel per vitin e meparshem.

NENI 12

Asambleja drejtohet nga Presidenti i Shoqerise qe ne rastin konkret eshte zgjedhur Z.Bujar Tuku.

NENI 13

Vendimet e asamblese jane te vlefshme ne se ato jane miratuar nga te dy ortaket e saj.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 14

Shoqeria private "DEAN CUSTOM AGENCY" deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut e Kontrate si dhe ato te legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saje si person juridik ne Gjykaten e Rethit Tirane si dhe ushtron aktivitetin e saje me regjistrimin ne organet tatimore.

NENI 15

Shoqeria ka vulen e saje me permbajtjen "SHOQERIA DEAN CUSTOM AGENCY TIRANE".

NENI 16

Shoqeria private vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejta e detyrime kontraktore e jashte kontraktore brenda kapitalit te saj.Themeluesit bartin rrezikun per rezultatin e veprimtarise ne limitin e kontributit te sejcilit vene kapitalin e shoqerise.

NENI 17

Ortaket e Shoqerise,sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise ekonomike te Shoqerise,punesojne punetore dhe emertojne administratore,te cilet qendrojne ne detyre derisa revokohen nga Asambleja ose largohen me deshire.

Administratori i emeruar i ke te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te Shoqrise ne te ngjitha rethanat me perjashtim te kompetencave qe Ligji jep shprehimisht Asamblese se Shoqerise.

6

NENI 18

Presidenti i Shoqerise si dhe Administratori jane te veshur me te gjitha fuqite e zakonshme e te jashtzakonshme per trajtimin e Shoqerise pa asnje perjashtim.Ata kane mundesi te kryejne te gjitha aktet qe konsiderohen te pershtatshme per arritjen e qellimeve te Shoqerise.Ato kane te drejten te blejne e te kembejne pasuri,te lidhen me Shoqeri te tjera Shqiptare apo te huaja duke siguruara pjesmarrjen per qellimet e veprimtarise ekonomike te perdorura ne nenin 4 te ketij Statuti.Ato kryejne cdo lloj veprimi prane te gjitha zyrave shtetrore ose private qe kane te bejne me garancite e veprimet ipotekore,kryejne prane institucioneve bankare e financiare veprime depozitimi,kreditimi pagesa e arketime,qarkullime e letrave me vlere ne tregun e parase,kryejne blerje shitje dhe cdo operacion lidhur me tituj aksionesh e obligacionesh ne burse kombetare e te huaj,tituj shteti apo te garantuara nga shteti per llogari te Shoqerise apo te te treteve.

Ne te gjitha rastet administratori eshte i detyruar te njoftoje e te jape llogari Presidentit te Shoqerise duke mbajtur pergjegjsi civile e penale per kryerjen e detyrave te ngarkuara.

MAREDHENIET E PUNES

NENI 19

Presidenti i Shoqerise cakton Administratorin,te cilit ne aktin e e merimit i cakton detyren dhe pagen.Po keshtu dhe per punonjsit e punesuar.

NENI 20

Mardhenirt e punes ne Shoqeri regullohen nepermjet kontrates se punes.Per ceshtje qe nuk regullohen me kontrate pune,zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te Sigurimeve Shoqerore per te gjithe te punesuarit,ndersa keta te fundit jane te detyruar ta pranojne kete Statut te Shoqerise.

NENI 21

Mosmarreveshjet e te punesuarit me Shoqerine zgjidhen nga Gjykata Shqiptare.Kur pala ankuese eshte person i huaj,mosmarreveshje zgjidhet nga organi i percaktuar ne kontraten e punes.

PERFAQESIMI I SHOQERISE

NENI 22

Perfaqesimi i Shoqerise i perket Presidentit te Shoqerise dhe Administratorit te autorizuar prej tij.Ata kane te drejte te perfaqesojne Shoqerine ne organet gjyqesore e gjykime,te caktojne e te pushojne avokate per ceshtje ne gjykim.

SEKRETI I PUNES

NENI 23

Sekret pune paraqesin shkresat,materialet dhe aktet te cilat me

ligje e dispozita te vecanta si dhe vendime te nxjerra nga Asambleja e Shoqerise, jane shpallur sekret pune. Te gjithe te punesuarit ne Shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes se Shoqerise.

Te dhenat informative, bilance, plane dhe informacione mbi politiken ekonomike te Shoqerise, qe u jepet organeve te miratuara, firmosen nga Presidenti ose Administratori i autorizuar.

Detyra mbi ruajtjen e sekretit te punes nga te punesuarit ne Shoqeri vazhdon edhe mbas largimit te tyre nga kjo Shoqeri.

KONTROLLI I BRENDSHEM

N E N I 24

Kontrollin e brendshem, Shoqeria e organizon nepermjet eksperteve kontabel te autorizuar, te emruar me ose pa afat te caktuar. Keta ekspert kontrollojne e garantojne qe llogarite vjetore jane te regullta dhe qe japin pasqyrim real te rezultateve te operacioneve te vitit te kaluar financiar, te gjendjes financiare dhe trshegimise se Shoqerise ne fund te vitit financiar. Ata kontrollojne kontabilitetin e Shoqerise me detyrimet e pergjithshme, parimet e regullat per mbrojtjen e kontabilitetit sic percaktohet ne Ligjin Nr 7661, date 10-01-1993"PER KONTABILITETIN". Ata jane pergjegjes ndaj Shoqerise per pasojat qe rjedhin ndaj Shoqerise dhe te treteve per pasojat qe rjedhin nga fajet e nenvleftesimet e tyre ne ushtrimin e funksioneve perkatese.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

N E N I 25

Veprimet ekonomike dhe financiare te Shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti, pervec rasteve te vecante me urdher te Presidentit te Shoqerise. Administratori nzjerr bilancin kontabel te Shoqerise me rezultatin FITIM-HUMBJE ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per mbajtjen e kontabilitetit si dhe harton raport me shkrim per administrimin.

Raporti i administrimit, bilanci, inventaret dhe llogarite vjetore i nenshtrohen miratimit nga Asamblea e Shoqerise brenda nje afati 2 mujor nga data e mbylljes se vitit financiar.

Me miratimin e bilancit kontabel Asamblea vendos per krijimin e fondeve te ndryshme e te nevojshme per zhvillimin e saj, si fondin e akumulimit, fondin rezerve etj.

N E N I 26

Pas vecimit te fondeve te permendura me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale, te ardhurat neto u ndahen ortakeve te Shoqerise sipas kuotes se tyre ne formimin e kapitalit te Shoqerise.

SHPERBERJA E SHOQERISE

N E N I 27

Veprimtaria e Shoqerise pushon me mbarimin e afatit te caktuar ne aktin e krijimit ose edhe me pare, sipas propozimit te njerit prej ortakeve, kur Shoqeria nuk realizon fitime, ne raste falimentimi, privim te te drejtave per te ushtruar veprimtari tregtare ose kur ortaket heqin dore nga Shoqeria.

Pasi shlyen te gjitha detyrimet qe Shoqeria ju ka personave te

trete fizike e juridike,behet njoftimi i mbylljes ose likujdimit duke kryer formalitetet perkatese duke cregjistruar Shoqerine nga regjistri tregtar.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

N E N I 28

Ndryshime e plotesime eventuale te ketij Statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxirret vete Statuti.Ndryshimet nuk prekin personalitetin juridik te Shoqerise.

N E N I 29

Te gjitha kundershtimet e mundeshme midis ortakeve te Shoqerise i nenshtrohen kopetences se nje kolegji prej tre arbitrash nga te cilet sejcila pale cakton nga nje arbiter, ndersa i treti caktohet nga dy te paret.Arbitrat kerkojne zgjidhje ne mirkuptim dhe vendimet e tyre do te pranohen nga palet ne konflikt si shprehje e vullnetit te tyre.Vendimet merren ne vendin dhe ne kohen e parashikuar nga Asambleja e Shoqerise.

N E N I 30

Vendimet e kolegjit arbitral mund te apelohen vetem ne se njera nga palet kerkon arbitrazh te metejshem prane Gjykates se Rrethit Tirane ku eshte depozituar ky akt-themelues,Statut i Shoqerise.Vendimet qe merr kjo Gjykate jane te paapelueshme,te detyrueshme per palet.

N E N I 31

Ky Statut perpilohet ne disa kopje per tju shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet si pjese e dokumentacionit te formimit te Shoqerise Private "DEAN CUSTOM AGENCY" Tirane.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE PRIVATE

DEAN CUSTOM AGENCY" TIRANE

| | |
|---|---|
| EMER MBIEMER<br>Bujar Tuku | EMER MBIEMER<br>Laura Kasa |

TIRANE me 10-08-1993

6089/1
6293

KERKESE

GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

KERKUES :LAURA KASA, e bija e Skenderit lindur me 1964, banues ne Tirane madhor me zotesi juridike per te vepruar me nr. pasaporte AZ 084276.

OBJEKTI : Ndryshime ne statutin e shoqerise .

Une Laura Kasa sipas dokumenteve bashkengjitur , jam administratore e shoqerise " DEAN CUSTOM AGENCY " sh.p.k.., shoqeri e regjistruar ne Gjykate me vendimin nr .6089, date 13.8.1993.

Me vendimin e asamblese se ortakeve kemi vendosur largimin e ortakut Bujar Tuku nga shoqeria dhe transferimin e kuotave te tij nepermjet shitjes Laura Kases e cila mbetet ortake e vetme ne shoqeri me 100 % te kapitalit te shoqerise.

Kerkoj nga ana juaj si Gjykate qe te vendoset qe te gjitha keto ndryshime te pasqyrohen ne regjistrin tregtar ku eshte regjistruar shoqeria jone.

ADMINISTRATORI

LAURA KASA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR 1815 REP

VERTETIM

Sot ne daten 11.03.1999 ( nentedhjete e nente) perpara meje Mimoza Sadushi, notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. Durresit, Pall. 11, u paraqit personalisht administratori I shoqerise Laura Kasa si administratore e shoqerise "DEAN CUSTOM AGENCY " sh.p.k., banues ne Tirane, me zotesi te plote per te vepruar, me dokument identifikimi nrAZ 084276, e cila nenshkroi rregullisht para meje dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE

MIMOZA SADUSHI

PULLE TAKSE 100 LEKE R. SHQIPERISE

12

PULLE TAKSE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR 1914 REP
NR 420 KOL

ZYRA E NOTERISE
MALLKUCI - SADUSHI

## KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot ne daten 09.03.1999 ( nentedhjete e nente) perpara meje MIMOZA SADUSHI, Notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. " DURRESIT ", Pall. 11, u paraqiten personalisht palet :

SHITES : 1.BUJAR TUKU,i biri I SDubiut , banues ne Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte nr.AZ 45141.

BLERES : LAURA KASA e bija e Skenderit , lindur me 1964 ne Tirane , banuese ne Tirane, me zotesi te plote per te vepruar, me pasaporte nr.AZ 084276.

ME OBJEKT : Trasferim nepermjet shitjes te kuotave te Shoqerise " DEAN CUSTOM AGENCY " shpk, e regjistruar ne Gjykaten e Rrethit Tirane me Vendimin Nr. 6089,date 13.8.1993, me kapital prej 10000 USD.

Palet si me siper jane ortake te Shoqerise "DEAN CUSTOM AGENCY ", shpk, me nga 50% te kuotave baraz me 5000 USD sejcili.........................................................................................

Shitesi Bujar Tuku kuotat e tij prej 50% ose 50.000 leke , deklaron se ja shet ortakut tjeter Laura Kasa.

Pala blerese Z.Laura Kasa deklaron se eshte dakort te bleje kuotat e mesiperme , 50% ose 5000 usd, duke I likujduar menjehere dhe nuk kane me detyrime te tjera karshi njeri tjetrit.

Paleve ju be e ditur se me noterimin e kesaj kontrate ortaku Bujar Tuku largohet nga shoqeria dhe ortak I vetem I Shoqerise"Dean Custom Agency " shpk, me 100 % te kapitalit prej 10.000 usd , behet Z. Laura Kasa

Kontrata u hartua nga une Noteri ne kater kopje te njejta nga te cilat nje kopje ruhet tek Noteri, nje kopje dorezohet ne Gjykate dhe dy kopjet e tjera I dorzohen paleve, ju lexua paleve me ze te larte dhe qarte te cilet e kuptuan permbajtjen e saj dhe meqenese ajo shpreh vullnetin e tyre te lire dhe te plote e nenshkruan ate perpara meje dhe une e vertetoj ate sipas ligjit.

S H I T E S

BUJAR TUKU

B L E R E S

LAURA KASA

N O T E R E

MIMOZA SADUSHI

14

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
N O T E R I A

Nr. 18341 Rep.

Nr. 6421 Kol.

# V E R T E T I M

Sot me daten _______ 1993, para meje noteres u paraqiten personalisht Z.Bujar Tuku e Znj.Laura Kasa resektivisht me numer Pasaporte AZ45141? dhe AZ0842 6 per identitetin e te cileve u sigurova nga leternjoftimet e tyre personale te cilet me deklaruan se sa me siper kjo kontrate e ky statut jane hartuar per Shoqerine e krijuar prej tyre me emertimin "DEAN CUSTOM AGENCY" dhe se nenshkruajne me vullnetin e tyre te lire e te plote çdo faqe te tyre.
Une notere e vertetoj ate regullisht.

N O T E R E
Mimoza Sadushi

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E DREJTESISE NOTERIA TIRANE

10

6081

K E R K E S E

GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Objekti : Regjistrimin si person juridik te shoqerise trgtare emertuar "DEAN CUSTOM AGENCY" Tirane, themeluar ne ortakeri nga ana :

1- Zotit Bujar Tuku, i biri i Subiut, lindur me banues ne Rr. "Pjeter Bogdani", vila 39 Tirane dhe
2- Zonjes Laura Kasa e bija e Skenderit, lindur me 25-04-1964 ne Tirane, banuese ne Tirane, Rruga "Mine Peza"Pa.2/1, shk.1, ap.6.

Bazuar ne legjislacionin ne fuqi kemi themeluar Shoqerine trgetare me pergjegjsi te kufizuar, emertuar"DEAN CUSTOM AGENCY" Tirane, ne ortakeri nga te dy te nenshkruarit per te cilen paraqesim kete kerkese per njojen e regjiistrimit si person juridik nga ana e Gjykates.

Shoqeria ka nje kapital prej 10.000 USD, ka sline e saje ne Tirane dhe nje afat veprimtarie mbi 10 vjet.

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine ekonomike ne fushat sic eshte percaktuar ne nenin nr.4 te Statutit bashkengjitur.

Meqenese si themelimi i Shoqerise sone, ashtu dhe objekti i veprimtarise se saj mbeshtetet ne ligj, lutemi asaj Gjykate, pasi te legjiishmerine e kesaj kerkese, te caktoje nje date per gjykimin e te vendose per regjistrimin e Shoqerise si person Juridik.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE TREGETARE

"DEAN CUSTOM AGENCY" TIRANE

(Bujar Tuku) (Laura Kasa)

Kasa

Te regjistrohet
dt. 13-8-93
Nikolla

Tirane, me 10-08-1993

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NOTERIA 18275
6405 VERTETIM

Sot, me daten 13.8.1993, para meje Noteres, mu paraqitan personalisht Bujar Tuku, biri i Zyhdiut, lindur ne Tirane me 1956 dhe banues ne Tirane dhe LAURA KASA, bija e Skender lindur ne Tirane me 1964 dhe banuese ne Tirane te pa njohur prej meje mase identitetin e tyre e sigurova nga letenjoftimi personal te cilet me deklaruan se kerkesa e siperme eshte sipas vullnetit te tyre te lire dhe te plote dhe ne baze te ligjes mene shkrei para meje Noteres.

NOTERE